



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-8007/20 datë:29.05.2020



Npi – 01/114 datë: 10.06.2020

Duke u bazuar në nenin 12 pika (d) si dhe nenin 17 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Pastaj në nenin 5 pika (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068; Si dhe në bazë të nenit 5 pikat (1.2) dhe (1.3) të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.15/2019, për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e zgjedhjes së Drejtorit dhe/ose Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar. Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më: 10.06.2020, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E KANDIDATËVE SIPAS KONKURSIT PËR ZGJEDHJEN E DREJTORËVE PÛRKATËSISHT ZËVENDËS-DREJTORËVE TË SHKOLLAVE NË KOMUNËN E SHTIMES

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më: 10.06.2020, me shumicën e votave aprovoi Vendimin për formimin e Komisionit për vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar sipas kriterëve të Konkursit në postin e Drejtorit, përkatësisht Zëvendës-Drejtorit, në Institucionet edukativo-arsimore të komunës së Shtimes, për të gjitha konkurset që do të shpallen gjatë vitit shkollorë 2020/2021 përkatësisht deri më 31 Gusht 2020, si vijon:

Anëtar i Komisionit nga Ekzekutivi i Komunës, përkatësisht nga DKA:


1. Fatmir Zymeri – Zyrtar për Arësim,

Anëtar i Komisionit nga Këshilli i Prindërve të Nxënësve në Komunën e Shtimes:

2. Basri Hyseni – Kryetar i Këshillit të Prindërve.

II

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Anëtarëve të komisionit, Drejtorisë për Arsim, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj